



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 183 prot.

Tiranë, më 12.02.2020

V E N D I M

Nr. 15, datë 12.02.2020

**MBI PËRFUNDIMIN E VERIFIKIMIT TË INFORMACIONIT, PËR PALIGJSHMËRI TË
KRYERA NË PROCESIN E KONKURRIMIT PËR PRANIM NË TND,
TË SHTETASIT *******

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dokumentar të mbledhur për verifikimin e ligjshmërisë së pranimit në konkurrimin për TND, të shtetasit *****,

VËREJ :

Pas marrjes së një informacioni për qëndrime favorizuese në procedurën e konkurrimin për pranimit të drejtpërdrejtë në TND, për pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm” në Ministrinë e Drejtësisë, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, kryesisht, ka filluar verifikimin e këtij rasti.

Në këtë kuadër, nëpërmjet shkresës nr. 1514/1 prot., datë 22.10.2019 “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me vlerësimin e dosjes së aplikimit për kandidatit ***** për procedurën e pranimit në TND”, u kërkua prej Departamentit të Administratës Publike, gjithë dokumentacioni që përmbante dosja e aplikantit, mbi bazën e të cilave është bërë edhe verifikimi i plotësimin të kriterëve të nevojshme të pranimit në TND, për procedurën e pranimit të drejtpërdrejtë në TND për vitin 2019, të hapur edhe për kandidatë të tjerë, nga jashtë shërbimit civil.

Nga analiza e materialeve shkresore të dërguara nga Departamenti i Administratës Publike, nëpërmjet shkresës nr. 6296, datë 04.11.2019, “Kthim përgjigje suajës nr. 1514/1 prot., datë 22.10.2019”, rezultoi si më poshtë:

Departamenti i Administratës Publike, në zbatim të Vendimit nr. 215 datë 17.04.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND për vitin 2019” ka shpallur Procedurën e Pranimit të Drejtpërdrejtë në TND (<http://dap.gov.al/vende-vakante/shpallje-tnd>), për vitin 2019, të hapur edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil, duke parashikuar shprehimisht edhe kriteret minimale të pranimit/rekrutimit për kandidatët që do të aplikojnë për këtë procedurë

Kandidati ******, pasi është njohur me shpalljen për konkurrim, ka aplikuar për të marrë pjesë dhe për këtë, në datën 16.05.2019, (afati i fundit, për dorëzimin e dokumentave sipas shpalljes së publikuar është 20 Maj 2019) ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm mbi bazën e të cilit do të bëhej verifikimi i plotësimit të kriterëve minimale të pranimit.

Departamenti i Administratës Publike pasi ka bërë vlerësimin paraprak të dosjeve të aplikantëve, ndërmejt tyre edhe dosjen e aplikantit ******, nëse i plotësojnë kriteret specifike të përcaktuara në VKM nr. 215, dt. 17.4.2019 dhe në shpalljen për konkurrim, të publikuar në faqen zyrtare të DAP dhe portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, ka publikuar rezultatet e verifikimit paraprak dhe në të njëjtën kohë ka njoftuar kandidatët e kualifikuar (ndërmjet tyre edhe ******) për datën në të cilën do të zhvillohej procesi i testimit. Në përfundim të procesit të testimit, nëpunësi ****** është shpallur fitues dhe mbi këtë bazë, Departamenti i Administratës Publike, me aktin nr. 4067 dt. 08.07.2019, në vijim të shkresës nr. 5083/1 dt. 5.7.2019 të Ministrit të Drejtësisë, me lëndë “Kthim përgjigje mbi përzgjedhjen e anëtarit të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues”, është emëruar “Sekretar i Përgjithshëm” në Ministrinë e Drejtësisë.

Për vlerësimin e ligjshmërisë së këtij procesi, u zhvillua hetim administrativ për verifikimin e të dy pretendimeve të ngritura në informacion, prej nga ka rezultuar:

Prendimi i parë: Konkurrenti ******, nuk plotësonte kushtet e eksperiencës dhe karrierës, për pranimin në TND.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, kushtet minimale për pranimin në TND për vitin 2019, në lidhje me përvojën në punë, për kandidatët që konkurrojnë nga jashtë shërbimit civil, janë përcaktuar në mënyrë të shprehur në shkronjën “c”, paragrafi i parë, të pikës 4, të VKM nr. 215, dt. 17.4.2019, sipas së cilës kandidatët nga jashtë shërbimit civil duhet që:

- Të kenë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në një pozicion të nivelit të mesëm drejtues ose të barazvlefshme, në:

- institucione të administratës publike;

- institucionet bankare të nivelit të dytë dhe që, aktualisht, nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;
- shoqëri tregtare, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, konsiderohen si biznes i madh dhe që, aktualisht, nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;
- organizata jofitimprurëse, të cilat kanë, të paktën, 5 (pesë) vite që janë krijuar.

Referuar shkronjës “c” dhe “ç”, të paragrafit të parë, të ndarjes II, të shpalljes së konkurrimit përcaktohet që për të provuar përmbushjen e kriterit të eksperiencës në punë, kandidatët që do të aplikojnë për këtë konkurrim, duhet të dorëzonin kopje të librezës së punës si dhe çdo dokumentacion që vërteton eksperiencën brenda ose jashtë vendit, të lëshuar nga punëdhënësi.

Për të vërtetuar përvojën në punë të kandidatit ******, “3 (tre) vjet përvojë pune në pozicione të mesme drejtuese ose të barazvlefshme”, u verifikuan shënimet e bëra në librezën e tij të punës, mbi fillimin, transferimin dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, ku punëdhënësi dhe kohëzgjatja e punësimit për këtë kriter rezultoi si më poshtë:

- Në Bankën e Shqipërisë Tiranë, Kryetar i Komisionit të Prokurimit, Zyra e Zv/Guvernatorit i Dytë, periudha 26 Shtator 2012-24 Prill 2015;
- Në Ministrinë e Drejtësisë, Këshilltar i Ministrisë, periudha 13 shtator 2018 e në vijim.

Bazuar në faktet e përmendura si më sipër, konstatohet që kandidati ******, në momentin e paraqitjes së dokumentacionit për konkurrim, kishte 7 muaj përvojë pune si Këshilltar i Ministrisë së Drejtësisë, pozicioni i cili barazohet në pagë me nëpunësin civil të nivelit të mesëm drejtues, kategoria II-b (Drejtor Drejtorie, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 8.3.2017 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë/Nëpunësve, Zëvendësministrit dhe Nëpunësve të Kabineteve, në Kryeministri, Aparatet e Ministrive të Linjës, Administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa Institucione të Pavarura, Institucionet në Varësi të Kryeministrit, Institucionet në Varësi të Ministrave të Linjës dhe Administratën e Prefektit (1)(2)”, dhe 2 vite e 7 muaj si Kryetar i Komisionit të Prokurimit në Bankën e Shqipërisë.

Për vlerësimin e nivelit të pozicionit Kryetar i Komisionit të Prokurimit në Bankën e Shqipërisë, u shqyrtua Statuti i saj, miratuar me Vendimin nr. 90, datë 01.12.2015 të Guvernatorit “Për miratimin e Statutit të Bankës së Shqipërisë”, nga përmbajtja e të cilit rezulton se bazuar në pikën 2, të nenit 1, Kreu I, Banka e Shqipërisë është person juridik publik me pavarësi administrative e për rrjedhojë referuar pikës 6, të nenit 3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, përfshihet në personat juridikë të cilat ushtrojnë funksione administrative me karakter publik. Nga përmbajtja e statutit sqarohet gjithashtu, se paga e Kryetarit të Komisionit të Prokurimeve barazohet me pagën e Zëvendës drejtorit të Departamentit në Bankën e Shqipërisë (Rregullore për procedurat e Prokurimit në Bankën e Shqipërisë, miratuar me Vendimin nr. 81 datë 15.11.2006 i Këshillit Mbikëqyrës, i ndryshuar) për rrjedhojë, nisur nga niveli i pagës dhe nga fakti që zbatimi i procedurave të prokurimit, është

një veprimtari që lidhet drejtpërdrejtë me zbatimin e politikave të përcaktuara nga ligjvënësi në këtë fushë, kjo eksperiencë pune vlerësohet përvojë pune si drejtues në institucione të administratës publike. Pra

Sa më sipër, nga llogaritja e përvojës në punë të konkurrentit ***** , në pozicione të nivelit të mesëm drejtues, ose të barazvlefshme, në institucione të administratës publike, nga pikëpamja numerike rezulton 3 vjet e 2 muaj kohë, përvojë e cila është e mjaftueshme për të marrë pjesë në konkurrim.

Pretendimi i dytë: Konkurrenti ***** është kualifikuar në kundërshtim me shkronjën “dh” të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe me shkronjën “ç”, të pikës 4, të VKM nr. 215, dt. 17.4.2019, të cilat kërkojnë, respektivisht, që:

Konkurrenti të mos ketë masë disiplinore për largim nga shërbimi civil, që nuk është shuar; të mos ketë procese gjyqësore, civile, penale, administrative të cilat janë në proces, si dhe të mos jetë në ndjekje penale nga prokuroria.

Në përfundim të procesit të verifikimit në lidhje me këtë pretendim, rezulton se konkurrenti ***** ka pasur një mosmarrëveshje civile me Bankën e Shqipërisë, që lidhet me faktin e ndërprerjes së kontratës së punës me afat të caktuar, para përfundimit të saj, e cila është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor që ka përfunduar në disfavor të tij, me vendimin e formës së prerë, të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë në datën 31.01.2018 (*me të cilin është ndryshuar vendimi nr. 5881 dt. 19.11.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.*).

Ndërprerja e kontratës së punës para afatit të përfundimit të saj, pa shkak të arsyeshëm, nuk mund të barazohet me dhënien e një mase disiplinore për largim nga puna (*e cila konsiderohet shkak i arsyeshëm për ndërprerjen e kontratës së punës*), prandaj pretendimi se konkurrenti ***** është pranuar të marrë pjesë në procedurën administrative të pranimit në TND, për pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm” në Ministrinë e Drejtësisë, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit për pranimin në shërbimin civil, nuk mund të pranohet.

Banka e Shqipërisë nuk është institucion që përfshihet në shërbimin civil dhe marrëdhëniet e punës për punonjësit e saj rregullohen nëpërmjet ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i RSH” i ndryshuar.

Ky ligj, në nenin 203, pika 1 të tij (*ndryshuar pika 1, me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015*), rregullon edhe momentin e shuarjes së masës disiplinore, duke përcaktuar se “Afati i parashkrimit për masën disiplinore është një vit, nga momenti i marrjes së masës disiplinore, njoftuar me shkrim punëmarrësit”.

Në këto kushte, edhe sikur ndërprerja e marrëdhënies kontraktore të punës së shtetasit ***** , të ishte bërë për shkaqe të arsyeshme, siç mund të jetë thyerja e rëndë e disiplinës në punë, megjithëse ajo nuk mund të konsiderohej largim nga shërbimi civil, e cila do të përbënte pengesë të drejtpërdrejtë për pranimin në shërbimin civil, tashmë do të ishte e parashkruar.

Po kështu, gjatë hetimit administrativ të kryer, nuk u gjet ndonjë e dhënë që ndaj shtetasit ***** , në momentin e konkurrimit të kishte ndonjë masë disiplinore largim nga shërbimi civil në fuqi, ndonjë proces gjyqësor, civil, penal, administrativ në zhvillim, apo të dhëna se personi në fjalë ishte në ndjekje penale nga prokuroria.

Nisur nga gjithë sa më sipër, vlerësoj se procedura e kryerjes së konkurrimit për praninë të drejtpërdrejtë në TND, për pozicionin “*Sekretar i Përgjithshëm*” në Ministrinë e Drejtësisë, është kryer në përputhje me rregullat e legjislacionit të shërbimit civil, prandaj nuk ka shkaqe për vazhdimin e mëtejshëm të këtij hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE,

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; në pikat 1 dhe 2, të nenit 90, të ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në nenin 16, pika 6 dhe nenin 34, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

Arkivimin e rastit të hetimit administrativ kryesisht, në lidhje me ligjshmërinë e kryerjes së procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND, të konkurrentit ***** , në pozicionin “*Sekretar i Përgjithshëm*” në Ministrinë e Drejtësisë.

Për këtë vendim të njoftohen: Departamenti i Administratës Publike; Ministria e Drejtësisë, Avokatit të Popullit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha